



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2018:041269
Datë: 05.04.2024
Numri i dokumentit: 05549675

PAKR.nr.585/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për të Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Kadrije Goga Lubishtani, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Endrit Ajeti, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve, M.S. dhe A.S., që të dy nga Ferizaj, për shkak të veprave penale, në bashkëkryerje vrasje në tentativë, nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPK, dhe secili veç e veç, veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK, dhe G.P., nga Mitrovica, për shkak të veprave penale, vrasje në tentativë, nga neni 178 me nenin 28 dhe 31 të KPK dhe në bashkëkryerje mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.35/2015, të dt.10.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.20.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.35/2015, të dt.10.08.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.35/2015, të dt.10.08.2023, janë liruar nga akuza në kuptim të nenit 363 par.1 nën par.1.3 të KPPK, të akuzuarit, M.S. dhe A.S., për shkak të veprave penale, në bashkëkryerje vrasje në tentativë, nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPK, dhe secili veç e veç mbajtja në pronësi,

kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga nenin 374 par.1 të KPK, në mungesë të provave.

Në kuptim të nenit 363 par.1 nën par.1.3 të KPPK, i akuzuari G.P., për shkak të veprave penale, vrasje në tentativë, nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPK, dhe mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga nenin 374 par. 1 të KPK, në mungesë të provave.

Në kuptim të nenit 374 par.3 të KPK, janë konfiskuar në mënyrë të përhershme katër gëzhoja, tri predha, një shufër e gumës si dhe një plumb 7x62mm.

Shpenzimet procedurale penale kanë ra në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka ushtruar Prokuroria Themelore në Ferizaj, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që ankesa të aprovet si e bazuar dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja penale ti kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim e vendosje, ose i njëjti aktgjykimi të ndryshohet dhe të akuzuarit të shpallen fajtor dhe t'iu shqiptoj një sanksion penal të paraparë me KPK, dhe me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit në bazë të nenit 38 të KPK.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/I.nr.530/2023, të datës 03.10.2023, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar nga ana e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, aktgjykimit të ankimuar, si dhe shkresave të tjera të lëndës, ka propozuar që ankesa e ushtruar të aprovet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.35/2015, të dt.11.08.2023, të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje, ose të njëjtit ti shpall fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji ka caktuar seancën e kolegjit për datën 20.03.2024, dhe në mënyrë të rregullt i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit kanë prezantuar, i akuzuari A.S., i shoqëruar nga Njësia e Transportit të Paraburgosurve, dhe mbrojtësit të akuzuarit M.S., av.Avni Ibrahim, ndërsa nuk kanë prezantuar Prokurori i Apelit, të akuzuarit M.S. e G.P., dhe mbrojtësit e të akuzuarve, A.S., av.Vesel Jashari, e G.P., av.Kadri Osaj, përkundër asaj që janë njoftuar në mënyrë të rregullt, sikurse vërtetohet nga shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.S., av. Avni Ibrahim, përkundër asaj që nuk ka ushtruar ankesë, ka deklaruar se e kundërshton në tërësi si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Themelore, duke shtuar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, ku është vërtetuar në mënyrë të plotë gjendja faktike, se i njëjti nuk e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, kurse ato pretendime të cilat i ka cekur prokuroria në ankesë, nuk janë vërtetuar me asnjë provë të vetme, andaj ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e prokurorisë,

kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

I akuzuari A.S., ka deklaruar se e mbështet në tërësi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, dhe kërkon që i njëjti aktgjykim të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenin 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, nga ana e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, aktgjykimin të ankimuar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, nuk është e bazuar.

Sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke theksuar se në këtë çështje penale të akuzuarit M.S. dhe A.S., janë liruar nga akuza për shkak të veprës penale në bashkëkryerjes, vrasje në tentativë, nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPK, si dhe secili për shkak të nga një veprë penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK dhe i akuzuari G.P., për shkak të veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPK dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 të KPK.

Sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të njëjtat rezultojnë pasi që gjykata e shkallës së parë, ka vendosur që të akuzuarit ti liroj nga akuza, ashtu që gabimisht ka konstatuar se me asnjë provë nuk ka arritur që të vërtetohet se të akuzuarit kanë kryer veprat penale të cilat u vihen në barrë. Në këtë çështje penale jemi të mendimi se nuk janë vlerësuar në masë të duhur të gjitha provat personale, ngase dëshmitarët në këtë çështje penale e sidomos F.S., në mënyrë të qartë shpjegon ngjarjen e ndodhur ditën kritike, te pompa e derivateve “Kema Petroll”, duke deklaruar se ka pasur shkëmbim me armë të zjarrit në mes tyre, edhe pse bazuar në deklaratat e të akuzuarve, nuk ka mundur që të vërtetohet kjo rrethanë. Po ashtu në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, rezulton se shkeljet esenciale janë evidente, se gjykata e shkallës së parë, nuk ka vlerësuar në masë të duhur që të gjitha rrethanat e kryerjes së të njëjtave, për të vërtetuar kryerjen e veprës penale, përkundër asaj që është vërtetuar qëllimi, motivi, koha, mënyra dhe vendi i kryerjes së veprës penale. Që të gjitha këto pa rregullsi e bëjnë aktgjykimin të pa qartë dhe të pa kuptueshëm.

Kolegji i kësaj gjykata ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me pretendimet sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, përkritazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe ka ardhur në përfundim se dispozitivi i aktgjykimin në pikën I, II, III dhe IV, është i qartë i kuptueshëm dhe në harmoni me vetveten, si dhe me pjesë të tjera të aktgjykimin, sikurse është arsyetimi, sepse i njëjti përmban faktet vendimtare të cilat i karakterizojnë veprat penale, për të cilat është zhvilluar procedurë. Gjithashtu nga vlerësimi i përgjithshëm i secilës pikë të dispozitivit të aktgjykimin, kolegji ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të qartë ka propozuar që të akuzuarit M.S. dhe A.S., janë liruar nga përgjegjësia penalo juridike, lidhur me veprën penale të vrasjes në tentativë dhe

bashkëkryerje nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPK, dhe secili i akuzuari për shkak të nga një vepre penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, e po ashtu edhe për shkak të akuzuarit G.P., është liruar nga përgjegjësia penalo juridike, lidhur me veprën penale të vrasjes në tentativë dhe bashkëkryerje nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPK, dhe secili i akuzuari për shkak të nga një vepre penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, sepse nuk është provuar se asnjëri nga ta kanë kryer veprat penale, për të cilat janë akuzuar.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar se aktgjykimi pasi që nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase rrjedha e zhvillimit të procedurës penale, përkitazi me veprimet e ndërmarra, sikurse janë vlerësimi i provave materiale, po ashtu atyre personale, qojnë në drejtim të asaj që të akuzuarit të lirohen nga akuza, në kuptim të nenit 363 par.1 nën 1.3 të KPPK.

Gjatë vlerësimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, kolegji ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përshihet as me shkelje të parapara në nenin 384 par.2 pika 2.7 të KPPK, lidhur me nenin 369 të KPPK, sepse përmbajtja si dhe forma e aktgjykimit me shkrim, është konform dispozitës përkatëse ligjore, sepse aktgjykimi përmban të gjitha pjesët kryesore që duhet ti ketë, sikurse është hyrja, dispozitivi si dhe arsyetimi e që të gjitha këto pjesë përbërëse të aktgjykimit, kanë lidhje të përafërta në mes veti. Në aktgjykim gjykata e shkallës së parë në pjesën hyrëse ka përfshirë të gjitha çështjet që duhet ti ketë aktgjykimi, sikurse edhe në dispozitiv që ka paraqitur pjesët përbërëse të të njëjtit, duke precizuar në mënyrë të qartë çdo veprim inkriminues të secilit të akuzuar, që në rastin konkret është i pa realizuar, për atë arsye edhe i ka liruar nga akuza.

Po ashtu gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme për secilën pikë të aktgjykimit, duke arsyetuar të njëjtin dhe duke dhënë arsye të qarta dhe të plota, se cilat fakte konsiderohen të vërtetuara apo të pa vërtetuara, që në rastin konkret nuk janë vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve, janë formuluar elementet inkriminuese të veprave penale të cilat u vihen në barrë, e po ashtu ka zbatuar procedurën, konform dispozitave përkatëse ligjore, duke pasur parasysh çdo propozim të mbetur dhe dhënë arsye të mjaftueshme, lidhur me çështjen penale, përkitazi me ekzistimin e veprës penale.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke pretenduar prokuroria se gjykata e shkallës së parë, nuk i ka vlerësuar në masë të duhur deklaratat e të akuzuarve, sepse nga deklaratat e dhëna në polici, prokurori, dëshmitari F.S., përkundër asaj që ka bërë përshkrimin e rastit të ndodhur, duke theksuar se ditën kritike, ka ardhur në Ferizaj së bashku me të akuzuarin G.P., të cilin e ka dajë, dhe më pastaj kanë shkuar në familjen S., gjatë rrugës kanë takuar një veturë të tipit “BMW”, dhe nga kjo veturë ka filluar gjuajtja me armë dhe pastaj nga frika janë larguar, ndërsa afër rreth rrotullimit po nga e njëjta veturë dhe nga vetuar e tipit “Volvo”, kanë filluar gjuajtjet dhe të shtënat dhe është qëlluar vetura ku ka qenë së bashku me G.P.. Po ashtu edhe dëshmitari A.A., ka deklaruar se ditën kritike me veturën “BMW”, ka qenë me A., dhe pasi që janë nisur për te shtëpia e A., në rrugën e fshatit Pleshinë, përkatësisht te shitorja Basi, pasi kanë takuar një veturë “Pasar”, ngjyrë hiri,

shoferi i kësaj veture ka nxjerr armën dhe pastaj në ndërkohë janë takuar me të akuzuarit M., pastaj të tre së bashku me veturën “Volvo” të akuzuarit M., janë nisur tek rrethi, ndërsa aty kanë takuar G.P. me një person tjetër, ndërsa vozitësi i veturës Pasat, ka nxjerr armën dhe ka filluar të gjuaj në drejtim të tyre. Pas ballafaqimit me deklaratën e dhënë, në prokurori, dëshmitari F.S., duke u ballafaquar me të njëjtin në shqyrtim gjyqësor, ka theksuar, po unë e kam parë vetëm me armë, ka shtënë në fillim në rrugën afër shtëpisë djali i M., ndërsa më vonë tek rrethi ka shtënë vet M., ndërsa njëherë na kanë gjuajtur nga vetura “BMW”. I njëjti pasi që kërkohet nga gjykata të sqarohet përkritazi për deklaratën e dhënë, ka theksuar se kjo çka deklaroi në shqyrtim gjyqësor është e saktë. Nga shkresat e lëndës, po ashtu rezulton se me provat e siguruara, raportet e këqyrjes së vendit të ngjarjes, rezulton se është shkëmbyer me armë zjarri, nga dy lloj armësh, se janë gjetur katër copë gëzhoja të kal.9x19mm, të cilat janë gjuajtur nga e njëjta armë, po ashtu një fishek i kal.7.62x25mm, një shufër gome, të cilat janë vlerësuar nga ana e krim teknikës. Pas kontrollit dhe ekzaminimit të veturës të tipit “Pasar”, ngjyrë hiri, pronë e G.P.t, është gjetur brenda kësaj veture një fishek, nga e cila vërtetohet edhe posedimi i armës nga ana e Gazmendit. Në automjetin e tipit “Volvo”, pronë e të akuzuarit M.S., është një vrimë shpuese në pjesën e përparme të veturës e shkaktuar nga arma e zjarrit. Të akuzuarit përkundër asaj që mundohen ti shmangen përgjegjësisë penale - juridike, nga të gjitha provat në shkresat e lëndës rezulton se të njëjtit kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen e cila rezulton nga provat personale dhe materiale, andaj propozojmë që çështja penale të anulohet dhe ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë përkritazi me ankesën e prokurorisë, si dhe shkresat e tjera të lëndës dhe ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, sepse nga të gjitha provat materiale nga shkresat e lëndës sikurse janë raporti i ekzaminimit të automjetit “Pasar”, me targa 02-959-AP, të dt.12.07.2013, raporti i ekzaminimit të automjetit “Volvo”, me targa 00R-851, të dt.11.07.2013, ekspertiza balistike nr.AFK/2013-2340/2013-1898, e dt.28.02.2013, katër gëzhoja të gjetura në vendin e ngjarjes, tri predha të kal.9x19mm, një fishek i kal.7.62mm, fotografia e cila tregon vrimën shpuese në pjesën e përparme të veturës “Volvo”, raporti i forenzikës në vendin e ngjarjes, e dt.11.07.2013, një shufër gome, si dhe është bërë shikimi në fotografitë tjera që gjenden në shkresat e lëndës. Po ashtu nga vlerësimi edhe i provave personale, duke filluar nga dëgjimi i dëshmitarit F.S., deklarata e dhënë në shqyrtim gjyqësor me dt.14.09.2022, i njëjti, deklaroi se ngel pranë deklaratës së dhënë në polici, duke shtuar këtu të akuzuarin G.P., e ka dajë, të njëjtit i ka thënë që të shkojnë në Ferizaj, për të marrë disa të holla dhe se tanë biseda e zhvilluar në atë drejtim, kurse sa i përket çështjes së të shtënës me armë të zjarrit, ka dëgjuar që Gazmendi, i ka thënë fjalët “më rroki mua”, duke vazhduar rrugën për në Prishtinë, dhe e kanë lajmëruar policinë se i ka sulmuar dikush me armë, se kanë problem me ta. Po ashtu thekson se nuk e kam vërejtur se kush i ka sulmuar, se nuk e njeh A.S. nuk është e vërtetë se e ka parë M. apo A.. duke e gjuajtur me armë.

Po ashtu dëshmitari A.A., në seancën gjyqësore të dt.31.10.2022, i kujtohet se ngjarja ka ndodhur në vitin 2013, se ka qenë ditën kritike duke pirë kafe me A.S., në Ferizaj, dhe se e ka thirrur bashkëshortja, duke i thënë eja në shtëpi se kanë ardhur nga Mitrovica, pasi që ke lënë takim. Përndryshe e ka ditur që ka pas takim dhe i ka treguar M., ngase duhet të bisedojmë me disa

persona, por i njëjti deklaroi se nuk ka vërejtur që ta ketë goditur dikush me armë, se kush ka shtënë në drejtim të tyre, ashtu që nuk është i sigurt, për rastin e ndodhur ditën kritike.

Nga deklarata e të akuzuarit M.S., i njëjti thekson se është e vërtetë se e ka takuar Gazmendin, i cili ishte ulur në oborr në një karrige dhe menjëherë kanë filluar që të bisedojnë përkitazi me çështjen e vajzës së tij, dhe disa të holla, në shumën duke mos iu kujtuar a kanë qenë 2.000 apo 7.000 Euro, për rregullimin e letrave për qëndrimin në shtetin e Suedisë, dhe deklaroi se ka dalur me veturën e tij dhe që të tre kanë dalur me te, kështu që me të arritur te pompa e benzinës “Fitorja”, vozitësi i veturës “Pasar”, kishte shtënë në drejtim të veturës së tyre “Volvo”, duke e goditur në pjesën e përparme të ftohësi i ujit, dhe se edhe më pastaj kanë vazhduar, por nuk e ka parë se nga kush është goditur.

Gjithashtu edhe i akuzuari A.S., bënë përshkrimin e kësaj situatë duke përshkruar se nuk e dinë se nga kush është gjuajtur, por vetëm e dinë se vetura e tyre kishte pësuar defekt, dhe e ka dërguar për ta rregulluar. Edhe i akuzuari G.P., ka shfrytëzuar të drejtën e tij që të mbrohet në heshtje, përkundër asaj që në deklaratat e më parme ka dhënë deklarin përkitazi me këtë çështje penale.

Gjykata pasi që ka vlerësuar të gjitha deklaratat si dhe provat materiale lidhur me gjendjen faktike në këtë çështje penale, ka theksuar se nuk ka mundur që të vërtetoj se në veprimet e të akuzuarve, janë formuluar elementet e veprave penale, për të cilat janë akuzuar, dhe se pasi që nuk ka mundur që të vërtetoj se në veprimet e secilit prej tyre, ka elemente të mjaftueshme të ekzistimit të veprave penale, në këtë çështje penale, ka vlerësuar edhe deklaratën e dëshmitarit A.A., i cili ka deklarua që ditën kritike ka arritur që ta takoj G., dy herë dhe atë njëherë të kryqëzimi i rrugës dhe njëherë tek rrethi ku gjendet një shqiponje e vendosur, më konkretisht e kemi vërejtur një lëvizje, dhe veturën e cila është kthyer në anën e djathtë dhe rrugës në lëvizje e kam vërejtur se vozitësi ka shtënë, pasi që e ka qit dorën jashtë në drejtim tonin që ishin prapa asaj veture, por duke theksuar se nuk i kujtohet dhe nuk dinë kush është ai që ka shtënë. Nga të gjitha këto prova të cilat gjykata e shkallës së parë i ka pasur në shqyrtim nuk ka mundur që të vërtetoj se në veprimet e asnjërit nga të akuzuarit janë formuluar elementet qenësore të veprës penale e cila u vihen në barrë, andaj në mungesë të provave i ka liruar që të gjithë nga akuza në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPK.

Ankesë në këtë çështje penale, për shkak të shkeljes së ligjit penal, ka ushtruar prokuroria, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur që të vërtetoj në mënyrë të qartë dhe të plotë elementet inkriminuese të secilës veprë penale, ashtu që aktgjykimi i ankimuar duhet të anulohet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje, ose që të ndryshohet dhe të akuzuarit të shpallen fajtor për veprat penale që u vihen në barrë dhe të dënohen sipas ligjit.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së ushtruar përkitazi me shkeljet e ligjit penal, e pasi që vlerësoi edhe shkresat e tjera të lëndës, ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penela ka ardhur në përfundim se nuk kemi të bëjmë me shkelje të ligjit penal, sepse veprat penale për të cilat të akuzuarit janë akuzuar, nuk

janë të kryera nga ana e asnjërit nga të akuzuarit, ashtu që në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar se ekzistojnë rrethanat që e përjashtojnë secilin të akuzuar nga përgjegjësia penale dhe ndjekja penale dhe se gjykata e shkallës së parë të gjitha veprimet procedurale i ka ndërmarrë në kuadër të autorizimeve ligjore.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.585/2023, të datës 20.03.2024

**Procesmbajtës,
Endrit Ajeti**

**Anëtarët e kolegjit,
Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit,
Xhevdet Abazi**

Kadrije Goga Lubishtani